



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/120

Datë: 25.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen koncept-dokumentet e Ministrisë së Punëve të Jashtme si në vijim:
 - 1.1. Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe
 - 1.2. Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-44 për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/120

Datë: 25.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke pasur parasysh Rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 28 shkurt 2013, të cilat janë nxjerrë me qëllim të zgjidhjes së çështjes së pensioneve të pensionistëve kosovarë të viteve të 90-ta, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Profesional Qeveritar i Republikës së Kosovës, për çështjen e pensionistëve Kosovarë, të cilët kërkojnë kompensim nga shteti i Serbisë për shkak të ndalesës dhe mos-pagesës së pensioneve pa bazë ligjore në vitet e 90-ta, si në vijim:

1.1. Sami Salihu, Drejtori i DAP-it në MPMS,	Kryesues;
1.2. Isuf Ajeti, Drejtor i ZRP-Gjilan,	anëtar;
1.3. Fadil Racaj, Drejtor i DL në MPMS,	anëtar;
1.4. Muhamet Gjocaj, Drejtor i DMS në MPMS,	anëtar;
1.5. Lulzim Karaxha, Drejtor i DKPIE në MPMS,	anëtar;
1.6. Adil Fetahu, BPIP të Kosovës,	anëtar;
1.7. Mazllum Baraliu, Rektor i U-Prizrenit,	anëtar;
1.8. Hasan Berisha,	anëtar;
1.9. Musa Limani, Përfaqësues i SP,	anëtar;
1.10. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit,	anëtar;
1.11. Përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë,	anëtar;
1.12. Përfaqësues i Ministrisë së Integrimeve Evropiane,	anëtar;
1.13. Përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme,	anëtar;
1.14. Përfaqësues i Trustit Pensional të Kosovës,	anëtar;
1.15. Përfaqësues i Fakultetit Juridik të UP të Prishtinës,	anëtar;
1.16. Përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë,	anëtar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë:

- 2.1. Hulumtimi dhe identifikimi i dokumentacionit përkatës që ndërlidhet me çështjen e pensioneve (ligjet, aktet nënligjore, vendimet, programet, raportet, strategjitë dhe dokumentet e tjera të Kosovës, si dhe ato të Serbisë), të cilat mund të shërbejnë si fakte për kompensimin e pensionistëve Kosovarë, nga shteti i Serbisë;
- 2.2. Hartimi dhe përgatitja e dokumenteve të nevojshme për palën kosovare në rast të bisedimeve eventuale në mes përfaqësuesve të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve të Serbisë, lidhur me kompensimin e pensioneve të pensionistëve Kosovarë;
- 2.3. Bashkëpunimi dhe komunikimi me Organet, institucionet dhe ekspertët vendor dhe ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes së pensioneve për pensionistët Kosovarë, pensionet e të cilëve u janë ndaluar pa bazë ligjore në vitet e 90-ta.
- 2.4. Mbledhja, grumbullimi dhe sistemimi i dokumentacionit të nevojshëm, i cili do të jetë në funksion të zgjidhjes së çështjes së pensioneve të pensionistëve Kosovarë të ndaluar nga shteti i Serbisë.
- 2.5. Ofrimi i këshillave ligjore falas për të gjithë pensionistët kosovar, të cilët kërkojnë kompensim nga Serbia për kontributet e dhëna pensionale, me qëllim të inicimit të procedurave për njohjen e së drejtës në kompensim për shkak të mos-pagesës së pensioneve, në gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg dhe në organet e tjera të gjyqësisë vendore dhe ndërkombëtare.
3. Me propozimin e Komisionit, nga pika 1. e këtij vendimi, nëse paraqitet nevoja për zgjidhjen e çështjes në fjalë, në mënyrë të suksesshme, Qeveria e Kosovës mund të angazhojë edhe ekspert tjerë vendor dhe ndërkombëtar.
4. Obligohet Departamenti i administratës pensionale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ti ofroj asistencë Komisionit.
5. Komisioni është funksional deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/120

Datë: 25.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Turqve të Kosovës për përkrahje financiare në vlerë 22,500.00 euro për festimin e 23 prillit, ditës së komunitetit Turk në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, kodi buxhetor 15600, dhe barten në xhirollogarinë e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Turqve nr. 20-12-0000131438-78 në bankën komerciale TEB.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/120

Datë: 25.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të komunitetit Rom të Kosovës për përkrahje financiare në vlerë 15,000.00 euro për festimin e 8 prillit, ditës së komunitetit Rom në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, kodi buxhetor 15600, dhe barten në xhirollogarinë e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Romëve nr. 1502001001850996 në bankën komerciale Raiffeisen.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/120


Datë: 25.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës merr përgjegjësitë e plota për marrjen e Aeroportit Ushtarak të Gjakovës, me rastin e transferimit nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Italisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
2. Themelohet komisioni për zhvillimin e procedurave për transferimin e Aeroportit Ushtarak të Gjakovës nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Italisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës në këtë përbërje:
 - 2.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - kryesuese;
 - 2.2. Ministria e Infrastrukturës - anëtar;
 - 2.3. Zyra e Kryeministrit - anëtar;
 - 2.4. Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 2.5. Ministria e Administratës Publike - anëtar;
 - 2.6. Ministria e Punëve të Jashtme - anëtar;
 - 2.7. Ministria e Financave - anëtar;
 - 2.8. Autoriteti i Aviacionit Civil - anëtar;
 - 2.9. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - anëtar;
 - 2.10. Ministria e Drejtësisë - anëtar;
 - 2.11. Ambasada Italiane në Prishtinë-anëtar.
3. Komision është përgjegjës për zhvillimin e procedurave për transferimin e Aeroportit Ushtarak të Gjakovës nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Italisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit/Marrëveshjes Teknike në të cilën do të specifikohen të gjitha detajet teknike të bartjes së përgjegjësisë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë